



Komercijalna banka
ad skopje

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN E GARANCIVE VALUTORE

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PUNËS ME GARANCI VALUTORE

Komercijalna banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm "Banka") jep garancive valutore (në tekstin e mëposhtëm "garanci") në përputhje me instruksionet e pranuar (kërkesën e dorëzuar dhe dokumentacionin përcjellës) nga Kërkuesi.

Në vendosjen e marrëdhënieve juridike të garancisë banka i paraprinë një marrëdhënie e caktuar (shpallja e tenderit, lidhja e marrëveshjes për blerje të mallit, pajisjeve, kryerjen e punëve ndërtimore dhe të ngjashme), në të cilën është e përfshirë klauzola financiare për detyrimin e Aplikantit të sigurojë garanci bankare në dobi të kreditorëve nga Marrëveshja themelore, përkatësisht Shfrytëzuesit të garancisë. Me klauzolën financiare në marrëveshjen themelore definohen të gjitha pyetjet në lidhje me garancinë: banka garantuese, shuma e garancisë, afati i vlefshmërisë, lloji i garancionit, kushtet e garancisë dhe të ngjashme.

Marrëdhëniet juridike që dalin nga garancia bankare janë autonome dhe të pavarura. Marrëdhënia mes Bankës dhe Kërkuesit të garancisë lind me lidhjen e marrëveshjes për dhënie të garancisë, ndërsa marrëdhënia juridike mes Bankës dhe Kërkuesit të garancisë vendoset me dhënie të garancisë.

Kërkuesi është i detyruar t'ia kompensoj Bankës secilën shumë, që Banka e ka paguar mbi bazën e garancisë.

Nëse Shfrytëzuesi i garancisë kërkon pagesë në përputhje me kushtet e garancisë (kreyn aktivizim të garancisë) dhe Banka vërteton se kërkesa për pagesë formalisht është e drejtë dhe përgjigjet kushteve të garancisë. Banka, duhet patjetër menjëherë ta kryej pagesën pas aktivizimit të garancisë, pa marrë parasysh se çfarë vërejtje dhe konteste dalin nga marrëveshja themelore, ose nga borxhi kryesor dhe pa obligim të vërtetimit të besueshmërisë së deklaratës që e jep Shfrytëzuesi në kërkesën e tij për pagesë.

Kërkuesi, nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë, sidomos me rastin e kërkesës për ndalesë përqësore apo padisë, ta pengojë Bankën ta realizojë pagesën pas aktivizimit të garancisë. Kërkuesi mund të bëjë vërejtje, parashtrësia apo padi sipas marrëveshjes themelore ekskluzivisht direkt ndaj Shfrytëzuesit në rrezik të vetin. Kjo, zbatohet edhe në rastet kur obligimi i garantuar nuk mund të realizohet për shkaqe që janë jashtë kontrollit të Kërkuesit të garancisë.

Duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë para se të japë instruksione dhe të dorëzojë kërkesë për dhënien e garancisë, Kërkuesi domosdoshmërisht duhet me kujdes ta definojë klauzolën financiare nga marrëveshja themelore me Shfrytëzuesin e garancisë.

Kërkuesi është i detyruar, para dhënies së garancisë ta kontrollojë propozim-tekstin e garancisë së kërkuar me shfrytëzuesin e garancisë dhe pas harmonizimit të plotë të tekstit dhe të gjitha elementeve të garancisë së kërkuar, bankës t'i dorëzojë propozim – tekstit të nënshkruar, me të cilin do ta shpreh pajtueshmërinë e tij për dhënien e garancisë së kërkuar, me tekstin e dhënë.

KOMPENSIME, PROVIZIONE DHE SHPENZIME

Nga moment i dhënies së garancisë (evidentimin në kontabilitet) dhe deri në likuidimin e saj (ndërprerjen kontabiliste), Banka nga Kërkuesi i garancisë arkëton kompensim për garancinë e dhënë.

Banka arkëton kompensime dhe provizione për ndryshimet e garancisë, apo çfarëdo lloj shërbimi tjetër, që Banka i kryen në lidhje me garancinë, shërbimet e shënuara, Banka është e detyruar t'i realizojë pas pagesës së kompensimeve dhe shpenzimeve për të njëjtët.

Kërkuesi, po ashtu do t'i bartë dhe të gjitha shpenzimet tjera të Bankës në lidhje me garancinë, duke i përfshirë edhe harxhimet që i paguajnë bankat tjera, si dhe shpenzimet juridike, që mund të ndodhin në lidhje me garancinë.

Për të gjitha kompensimet, provizionet, shpenzimet që do të ndodhin në lidhje me garancinë, Banka është e autorizuar të kërket nga llogaritë e Kërkuesit të hapura në Bankë, në valutë të huaj apo në denarë. Nëse në llogaritë e Kërkuesit nuk ka mjete të mjaftueshme, Banka do ta ngarkojë Kërkuesin në mënyrë adekuate.

Kërkuesi i garancisë është i autorizuar dhe me nënshkrimin e marrëveshjes për dhënien e garancisë e autorizon Bankën, pa pajtimin plotësues të tij, të vendosë urdhëresa dhe t'i shfrytëzojë mjetet në të gjitha llogaritë e tij të hapura në Bankë, për shkak të pagesës të çfarëdo që i detyrimi të ndodhur në vend apo jashtë vendit që kanë për bazë garancinë.

KONTROLLIMI DOKUMENTEVE

Të gjitha kërkesat për pagesë, deklaratat dhe dokumentet, që do të jenë të prezantuar pas dhënies së garancisë, Banka i kontrollon me kujdes të veçantë, që të vërtetohet se a janë ato sipas formës dhe pamjes në harmoni me kushtet e garancisë.

Banka nuk ka obligim të kryejë kontrollim të vlefshmërisë dhe autenticitetit të dokumentacionit përcjellës të dorëzuar kundrejt kërkesës (p.sh. Fatura, lista ngarkues, konosman, protokolle, certifikata, vërtetime, dokumente doganore dhe të shpëdicionit dhe çfarëdo lloj dokumentacioni tjetër përcjellës), si dhe nënshkrimeve të dokumentacionit përcjellës të dorëzuar me kërkesën për pagesën sipas garancisë, e as të kontrollojë besueshmërinë të deklaratave të dhëna nga Shfrytëzuesi të garancisë.

KOMUNIKIMET

Nëse Banka kërkon nga Kërkuesi instruksione dhe nuk pranon pa prezentim përgjigje me shkrim të tijin ose vërtetim me shkrim, ose Banka nuk ka mundësi, pa mos e shprehur afatin të kontaktoj me Kërkuesin, atëherë Banka ka të drejtë të vepruar sipas vlerësimit vetanak dhe të diskrecionit, duke i pasur parasysh interesat e Kërkuesit dhe rrethanave që i kanë qenë të njohura.

Banka do ta njoftojë Kërkuesin për çfarëdo lloj ngarkese, zvogëlimi ose likuidimi të shumës së garantuar si dhe për pranimin e kërkesës për pagesë, ose çfarëdo lloj dokumenti nga Shfrytëzuesi, të cilët janë me rëndësi për Kërkuesin.

LIKUIDIMI I GARANCIVE

Pas kalimit të afatit të vlefshmërisë, Banka do t'i likuidojë garancitë nga evidenca e saj e kontabilitetit.

Në çfarëdo rasti tjetër, Banka do të kryejë likuidimin apo zvogëlimin adekuat të shumës së garantuar të garancive të dhëna në evidencën e saj të kontabilitetit, vetëm pas plotësimit të kushteve të caktuara:

- pranimit të porosisë së shëruar SWIFT nga banka e Shfrytëzuesit ose nga banka shfrytëzuese e kësaj garancisë për lirim nga të gjitha ose një pjesë të obligimeve sipas garancisë.
- kthimit të garancive origjinale në Bankë,
- pas plotësimit të kushteve të caktuara të saktësuara në tekstin e garancisë,
- pas kryerjes së pagesës me kërkesë për pagesë nga Shfrytëzuesi i garancisë (garanci e aktivizuar), ose pas kryerjeve rregullisht të pagesës së detyrimeve të garantuara tek garancat e pagueshme vetëm për një herë të realizuara nga ana e kërkuesit të garancisë duke u thirr në numrin e garancisë.

Për shkak të kësaj, Kërkuesi i garancisë është i detyruar që gjatë çdo pagese pas aktivizimit të garancisë ose gjatë pagesës së detyrimeve të garantuara tek garancitë për përdorim të njëherëshëm me urdhër për pagesë (Formulari 1450), detyrimisht të thirret në numrin e garancisë.

Kërkuesi ka detyrim t'i ndëmerr të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij, që të mund të kryejë likuidimin e garancisë së dhënë.